



Të

gjitha a duhet të dish për Aids

MËNYRA NGJITJEJE | SIMTOMA
INFORMIM-PSIKOLOGJI | ANALIZA-TERAPI-STATISTIKË
+ FRAGMENTE TË LIGJIT 3304/2005

Sekretaria e Përgjithshme e Brezit të Ri



Sekretaria e Përgjithshme e Brezit të Ri me qëllim komunikimin, informimin dhe sensibilizimin e masës së të rinjve të Greqisë për çështje shkencore dhe njëkohësisht thellësisht shoqërore, gjykoi të domosdoshëm botimin e një manuali përmbledhës por esencial informues për virusin e AIDS-it dhe njëkohësisht paraqitjen e kuadrit ligjor lidhur me « zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë, pavarësisht nga origjina racore ose etnike, besimeve fetare apo bindjeve të tjera, invaliditetit, moshës apo orientimit seksual », i cili është në fuqi nga data 27 Janar 2005 ku, midis të tjerash, mbron edhe bartësit e virusit nga dallimet eventuale në dëm të tyre në mjedisin e punës dhe më gjerë. Pyetjet të cilat përfshihen në manual u parashtruan nga të rinjtë/rejat që morën pjesë përmes internetit në veprimtarinë e informimit dhe sensibilizimit për virusin e AIDS që realizoi Sekretaria e Përgjithshme në muajin dhjetor të vitit 2010.

Tek site www.neagenia.gr secili mund të gjejë manualin në formë elektronike, por edhe të ndjekë gjithë veprimtarinë përmes kanalit youtube të Sekretarisë së Përgjithshme të Brezit të Ri. Ky manual shpërndahet falas në Athinë, Selanik dhe në qytete të tjera të Greqisë, si dhe gjithashtu disponohet në anglisht, frëngjisht, shqip dhe rusisht.

Urojmë që të gjithë ju që keni në dorën tuaj këtë material, ta konsideroni realisht të dobishme për luftimin e stereotipeve që synojnë të zëvendësojnë fjalën shkencore dhe të helmojnë marrëdhëniet njerëzore. Sekretaria e Përgjithshme e Brezit të Ri do të mbështesë çdo përpjekje në këtë drejtim.

.. Dije dhe komunikim kundër injorancës dhe stereotipeve.



Mirëkuptim dhe jo ndalim.



Një metodë - ilaç

kundër sëmundjes së
komfuzionit dhe frikës:



një
diskutim produktiv >



[përgjigje nga PRAKSIS]





1

*Mënyra
transmetimi*

Mënyra transmetimi

1.Nëse dua të bëj seks me një djalë, por mesa di unë, ai nuk ka bërë seks me ndonjë vajzë tjetër, duhet të përdorim prezervativ?

Së pari fakti që dikush thotë se nuk ka patur herë tjetër kontakt seksual nuk do të thotë se gjërat janë pikërisht kështu. Më tej, prezervativi nuk na mbron vetëm nga HIV (Human Immunodeficiency Virus) por edhe nga shtatzania eventuale e padëshiruar si dhe nga sëmundje të tjera seksualisht të transmetuara. Prandaj po, kurdoherë të përdoret prezervativ gjatë kontakteve seksuale, pavarësisht nga kushtet.

2.Gjatë seksit oral (gojor) duhet të përdoret prezervativi?

Po, duhet të përdoret prezervativi edhe gjatë seksit oral pasi lëngjet paraspermatike dhe spermatike përmbajnë sasira të mëdha të v i r u s i t dhe në këtë mënyrë bëhen të rrezikshme për transmetimin e tij.

3.AIDS ngjitet me puthje?

Jo, virusi HIV nuk ngjitet me puthjen pasi tek pështyma ekzistojnë sasira të pakonsiderueshme të virusit. Megjithatë mundësitë shtohen nëse dikush ka plagë të hapur brenda gojës ... psh. Afta (stomatit aftoz), gingivit e tj.



4.Unë shkoj në pishinë dhe atje notojnë edhe njerëz të rritur, nëse dikush nga ata është i prekur nga AIDS, do të ngjis?

Jo, nuk do të ngjisësh, virusi HIV është siç themi virus njerëzor dhe rron shumë pak minuta jashtë trupit të njeriut, pra nuk rron dhe nuk mbartet në ujë.

5.Rrezikohen fëmijët e mi të ngjisin AIDS nga fëmijët e tjerë në shkollë që eventualisht kanë virusin?

Jo askush nuk rrezikohet t'i ngjitet virusi HIV nga kontakti i thjeshtë shoqëror. HIV ngjitet nëpërmjet likuideve biologjike (gjak , spermë dhe transmetim direkt nga nëna tek fëmija përmes dhënies së gjirit (mekimit) pra nuk është e mundur ngjitja tek fëmijët nga bashkënxënësit e tyre.

6.Çfarë duhet të bëj nëse më pëlqen një femër që nuk e njoh por dua të kryej kontakt seksual më të?

Zgjidhja e vetme është përdorimi i prezervativit. Veç kësaj mund ti kërkes të ekzaminoheni së bashku për virusin me qëllim që të siguroheni që të dy pasi edhe ajo nuk të njeh mirë. Kjo sigurisht nuk do të thotë se pas ekzaminimeve do të kryeni kontakt seksual pa prezervativ pasi prezervativi na mbron edhe nga sëmundje të tjera të cilat ngjiten nëpërmjet kontaktit seksual.

7.Përmes tatuazhit mund të ngjisë dikush AIDS nëse gjilpera nuk është sterile?

Natyrisht po, mund të ngjit sepse ngjitja e virusit kryhet nëpërmjet likuideve biologjike dhe një nga këta është gjaku.

8.Nëse je dhurues gjaku duhet të kontrollohesh edhe për AIDS apo bëhet vetvetiu analiza pasi dhuron gjak?

Në qoftë se dikush shkon për të dhuruar gjak patjetër që bëhet analizë për virusin dhe nëse ka problem njoftohet nga shërbimi për analizë të mëtejshme. Megjithatë nëse dikush nuk jep gjak në intervale të rregullta, është mirë të kryejë analizë.

9.Përse AIDS është më shumë i përhapur tek homoseksualët (gay)? Janë më të pakujdesshëm?



Pikërisht, shkakun nuk është se janë më pak të kujdesshëm, madje shkakun është social, d.m.th. se ata shkëmbejnë më shpesh partnerë seksualë sesa heteroseksualët, por ky fakt në kohën e sotme përbën mit ngaqë shkëmbimi i shpeshtë i partnerëve vërrehet tashmë edhe tek heteroseksualët. Ky fakt na çon përfundimisht tek konkluzioni se AIDS na përket të gjithëve dhe të gjithë rrezikohemi njësoj prej tij.

10. Ekzistojnë ndryshime tek cilësia e prezervativëve? Si mund të dijë dikush se cilët janë më të sigurt dhe cilët jo? Është më mirë t'i marrësh nga farmacia?

Të gjithë prezervativët të kontrolluar me mjete elektronike, që ruhen në mjedis me hije dhe të freskët dhe shiten të ambalazhuar nga shoqëria prodhimi të afirmuara janë njësoj të sigurt. Vendi më i përshtatshëm për të blerë dikush prezervativë është farmacia, supermarketi dhe në përgjithësi aty ku prezervativët ruhen në ambiente të freskëta dhe në hije.

11. Nëse ke gingivit (sëmundje të mishit të dhëmbëve) rrezikohesh nga seksi oral (gojor)?

Rrezikohesh në kuptimin që përderisa mishrat e dhëmbëve tuaj kanë hemoragji, pra ekziston plagë e hapur, je më i predispozuar për të ngjitur **v i r u s i n**.

12. Është e vertetë se ngjitet **v i r u s i AIDS nga pinezat që vendosin disa persona në ndënjëset e sallave të kinemasë?**

V i r u s i i AIDS-it është virus njerëzor dhe rron shumë pak minuta jashtë trupit të njeriut. Rrjedhimisht nuk rron dhe nuk mbartet nëpërmjet sendeve të ndryshme.

13. Prezervativi është absolutisht i sigurt apo thjeshtë pakëson rrezikun? Je 100% i sigurt kur e përdor?

(sh.përkth: kësaj pyetjeje nuk i është dhënë përgjigje)

14. Përse e nënvleftësojmë akoma edhe sot kaq shumë këtë sëmundje? E snobojmë? Kur të gjithë e dimë se sa e rrezikshme është, cila është arsyeja e një sjelljeje kaq të papërgjegjshme ndaj shokut/shoqes tonë/sonë?



Arsyet janë të ndryshme dhe kryesisht kanë të bëjnë me mosdijën tonë dhe mungesën e informimit nga entet kompetente. E gjithë filozofia që po ndiqet është se nuk më përket mua (dhe këtu japim përgjigje të ndryshme në aparancë logjike përse nuk ka të bëjë me ne - p.sh. sepse jam straight, kam partnere të përhershme etj.) pra nuk ekzaminohe mi dhe nuk mbrohe mi.

15. Është i rrezikshëm seksi anal?

Seksi anal është një lloj i rrezikshëm me cilindo lloj seksi tjetër. Kjo ndodh pasi gjatë penetrimit, krijohen mikroplagë rrjepëse në vaginë, në anus kështu që lëngjet spermatike dhe paraspermatike ose ato vaginale, kalojnë më lehtë në qarkullimin e gjakut dhe ngjitet **v i r u s i**.

16. Një mik, homoseksual kishte marrëdhënie për një kohë të gjatë me një mbartës të AIDS-it. Kur ma tha, pësova histeri. Deklaronte i dashuruar si asnjëherë më parë dhe këmbëngulte se «tregonte kujdes». Unë mendoja gjithmonë më te këqen. Sa rrezikohej në realitet?

Nga çasti që mbartësi merr mjekimin e duhur, ndiqet nga mjeku dhe që të dy së bashku marrin masa profilaktike dhe ekzaminohen rregullisht, rreziqet e ngjitjes së **v i r u s i t** pakësohen seriozisht.

17. Virusi i HIV mund të infektojë dikë, nëse sperma e infektuar vjen në kontakt me ndonjë plagë? Ç' mundësi ekzistojnë që të ndodhë një gjë e tillë nëse plaga është e mbyllur ose ekzistojnë disa gërvishje?

V i r u s i ngjitet nëpërmjet lëngjeve biologjike (gjak, spermë dhe ngjitje direkte nga nëna tek foshnja përmes dhënies së gjirit). Kjo do të thotë se cilindo lloj kombinimi i lëngjeve biologjike, është propabilisht i rrezikshëm për ngjitjen e **v i r u s i t**, pavarësisht nga sasia e gjakut që ekziston lokalisht. Një plagë e hapur është gjithmonë plagë e hapur dhe e predispozuar për ngjitjen e **v i r u s i t**.

18. Mund të ngjitesh virusin nëpërmjet seksit oral?



Mund të ngjitësh AIDS përmes cilësdo rruge seksuale, ndryshimi i vetëm është përqindja e mundësisë së ngjitjes, ndonëse jo në shkallë shumë të madhe. Gjithësesi për shkak të hyrjes së lëngjeve paraspermatike, spermatike dhe lëngjeve vaginale në hapësirën gojore, është e mundshme ngjitja e virusit.

19. Nëse një grua shtatzan është mbartëse, cilat janë mundësitë e ngjitjes së virusit tek embrioni?

Mundësitë për të ngjitur virusin tek embrioni janë të shumta, prandaj për këtë është e domosdoshme të ndiqet nga mjeku gjatë gjithë kohës së shtatzanisë, kështu që është e domosdoshme të mbrohet si nëna edhe embrioni.

20. Është e mundur që një grua e martuar me një person seropozitiv të bëjnë fëmijë i cili të mos ketë virusin?

Po është e mundur që fëmija të jetë absolutisht e sigurt me kusht që si personi seropozitiv edhe çifti, ndiqet nga mjeku para shtatzanisë dhe ndjek udhëzimet e mjekut gjatë periudhës së shtatzanisë, lindjes e tij.

21. Gjatë kontaktit seksual me partner të përhershëm për shumë vite ekziston rreziku i infektimit?

Rreziku në këtë rast konsiston tek fakti se sa monogamike është marrëdhënia prej të dy palëve. Nëse kjo vertetohet si e tillë, atëherë nuk ekziston asnjë rrezik.

22. Ekziston mundësia të kesh kontakt seksual me një bartës pa përdorur prezervativ dhe të mos ngjitësh virusin?

Po ekziston mundësia, por meqenëse, nga njëra anë, nuk mund të llogaritet përqindja e saj dhe, nga ana tjetër, serioziteti i sëmundjes është i madh, e mira është që në çdo rast të merren masa profilaktike.

23. Përse nuk keni asnjë person aty që të mbështes edhe pikpamjen e kundërt? Domëthënë se AIDS-i nuk shkaktohet nga virusi HIV?

I gjithë komuniteti shkencor ndërkombëtar mbështet me të dhëna shkencore dhe studime shumëvjeçare se virusi HIV shkakton AIDS. Nëse dikush ka të dhëna analoge shkencore të bazuara dhe të provuara në mënyrë



të padiskutueshme me studime analoge për të kundërtën, është mëse i mirëpritur për t'i paraqitur. Por derisa të arrihet kjo nuk mund të paraqiten si të bazuara shkencërisht pikëpamje të cilat mbështeten në pikëpamje individuale, koinçidenca, fama ose hamendje.

24. Çfarë bëjmë kur prezervativi shpohet?

Në rast se prezervativi shpohet dhe kemi frikë të bazuar se mund të kemi ardhur në kontakt me virusin, mund t'i drejtohemi ndonjëres prej qendrave ekzaminuese të virusit që të informohemi nëse ka kuptim që të marrim në mënyrë profilaktike «tabletën e ditës së nesërme». Në rast të kundërt duhet të bëjmë analizë gjaku në çdo spital brenda një kohe shumë të shkurtër.

25. AIDS u përket më shumë homoseksualëve apo të gjithëve?

AIDS u përket të gjithëve pavarësisht seksit, preferimit seksual, klasës sociale ekonomike, racës, kombësisë. Të gjithë mund të ngjisin në çdo çast në qoftë se nuk marrim masa profilaktike, sepse të gjithë kemi jetë seksuale, të gjithë në një moment të jetës sonë mund të kemi nevojë për transfuzion gjaku. Virus është virus njerëzor dhe vetëm ky fakt tregon se u përket të gjithë njerëzve.

26. AIDS ngjitet nepërmjet djersës?

Jo, sasia e virusit në pështymë, në djersë dhe në lotë është kaq e vogël saqë e bën praktikisht të pamundur ngjitjen e tij.

27. Mirëmbërëma, para pak kohe kisha kontakt seksual me një prostitutë dhe gjatë aktit seksual u shpua prezervativi pa ejakulacion (hedhje të spermës) brënda saj, e konstatuam dhe u tërhoqëm, ekziston rreziku i AIDS-it? Kam dëgjuar se prostitutat kryejnë analiza çdo 15 ditë nga mjeku? Ka ligj të tillë në Greqi? Faleminderit.

Po, ashtu është, prostitutat ekzaminohen shumë shpesh nga mjeku për arsye të rrezikut të lartë që kanë nga profesioni që ushtrojnë. Por megjithëkëtë është e nevojshme të bëni analiza në ndonjë spital me qëllim që të jini i sigurt se nuk ka arsye shqetësimi.





2



simptomat ...

[përgjigje nga shoqata e seropozitëve
të Greqisë
«Zëri Pozitiv»]

Symptomat

1. Në cilat raste një bartës është i sëmurë?

- a) Të gjithë sëmurën pas disa viteve (kjo gjë ndryshon tek njerëz të ndryshëm).
- b) Në qoftë se do të djagnostikohesh dhe do të mjekohesh, në thelb kurrë.

2. Vdes dikush nga AIDS?

- a) Nëse dikush nuk djagnostikon infeksionin, atëherë rrezikohet shumë.
- b) Personat e vetëm që vdesin nga HIV/AIDS në Greqi janë persona të cilët u vonuan të djagnostikohen apo të fillonin mjekimin dhe si rezultat pësuan dëmtim të pariparueshëm të sistemit mbrojtës / imunitar.

3. Cilat janë simptomat /shënjat e HIV/AIDS?

- a) Simptomat e infeksionit primar.
- b) Interval i madh kohe pa asnjë simptomë.
- c) Shfaqje të mundshme të AIDS: lezionet kutane, herpes Zoster, pneumonia, infeksione bakteriale.

4. Kur një çift mund kryen kontakt seksual si mund të dijë çifti nëse ka virusin e HIV ? Domethënë cilat janë simptomat e para të HIV-it ? Ju faleminderit për kohën tuaj.



Simptomat e para çfaqen tek 87% e personave që infektohen nga HIV dhe demostrohen 2-3 javë pas infektimit dhe ngjajnë me shënjat e një ftohjeje të thjeshtë ose të gripit (temperaturë, dhimbje gryke, dhimbje koke, këputje).

5. Sa kohë kalon nga çasti që dikush infektohet deri tek shfaqja e sëmundjes?

a) 5- 15 vjet.

b) Nuk ka kohë konkrete, pasi varet nga shumë faktorë: nga organizmi, nga virusi dhe nga mënyra e jetesës.

6. Në sa kohë mund të kuptoj se kam ngjitur virusin me analizë gjaku? Çfarë simptomash do të çfaqen për shkak të virusit? Vetëm gay infektohen nga virusi?

Dhjetë (10) ditë pas simptomave të infeksionit primar ose afërsisht një muaj pas praktikës së rrezikshme seksuale ose përdorimit të shiringave për përqindjen e atyre që nuk paraqesin simptoma. Simptomat e para duken tek 87% e personave që infektohen nga virusi i HIV dhe shfaqen 2-3 javë pas infektimit dhe ngjajnë me shënjat e ftohjes së zakonshme ose gripit (temperaturë, dhimbje gryke, dhimbje koke, këputje). Të gjithë mund të infektohen nga virusi, burra, gra, straight ose gay).

7. Nëse dikush ka ekzantema në lëkurë dhe plagë në gojë duhet të shqetësohet se është infektuar nga HIV?

Ekzantemat në lëkurë dhe plagët në gojë nu lidhen me infeksionin nga HIV por me shumë sëmundje të tjera.

8. Ai që ka AIDS, rrezikohet më lehtë që të infektohet nga sëmundje të tjera si gripi i derrave?

Po.

9. Do të doja të pyesja nëse ne vet me ndonjë mënyrë mund të kuptojmë nëse kemi AIDS. Dua të them pa ndonjë analizë. Ose nëse ekzistojnë simptoma. Gjithashtu cilat janë mënyrat e transmetimit? Diçka tjetër përveç kontaktit seksual?

Dhjetë (10) ditë pas simptomave të infeksionit primar ose rreth një muaj pas praktikës së rrezikshme seksuale apo përdorimit të shiringave për ata që nuk paraqesin simptoma. Simptomat e para duken tek 87% e personave që infektohen nga virusi i HIV dhe shfaqen 2-3 javë pas infektimit dhe ngjajnë me shënjat e ftohjes së thjeshtë ose gripit (temperaturë, dhimbje gryke, dhimbje



koke, përgjumje, këputje).

Mënyra të tjera të ngjitjes së HIV janë:

1) Përdorim i përbashkët i shiringave kur merret doza e lëndëve narkotike, 2) tatuazh jo profesional dhe shpim i veshëve e tj. 3) shpime aksidentale me shiringa, 4) transfuzione me gjak të infektuar, 5) lindja, 6) dhënie gjiri.

10. Me ç' shënja shfaqet sëmundja e AIDS dhe si evoluohet klinikisht?

Shfaqen shënja në gojë, në grykë dhe në laring, temperaturë, humbje peshe, sëmundje të lëkurës, herpes, herpes i rishfaqur, lodhje, infeksione, ekzantema prej kancerit të lëkurës, simptoma neurognostike, si dhe të gjitha ato që shkaktohen nga infeksionet oportune dhe nga organizmat patogjene.

11. Sa kohë kalon që infeksioni i HIV të kalojë në AIDS?

Nuk ekziston kohë konkrete sepse varet nga shumë faktorë :

- a) 5 -15 vjet pa mjekim medikamentoz.
- b) Varet nga organizmi , virusi dhe mënyra e jetesës.

12. Si mund të kuptojë dikush se është infektuar nga HIV?

Duke kryer testin e posaçëm të antikorpeve.

13. HIV lidhet me sëmundje të tjera që ngjiten me kontakt seksual?

HIV ngjitet me të njejtën mënyrë, atëherë varet nga praktikat. Më tej sëmundjet që ngjiten me kontakt seksual ndihmojnë transmetimin e HIV për shkak të lezioneve që shkaktojnë në lëkurë dhe rritjen e ngarkesës virale të HIV tek personi që është seropozitiv.

14. Si mund të dallojmë nëse dikush është prekur nga AIDS? Ekzistojnë simptoma të jashtme të dukshme? Apo duken në stad të avancuar?

Shumica e njerëzve të infektuar nga HIV nuk duken të sëmurë. Në stad të avancuar shfaqet humbje peshe.

15. Si përballohet AIDS klinikisht në stadet e para?



Përballimi i tij në stadet e para bëhet me medikamente retrovirale. Mjekimi është shumë rezultativ dhe prognoza jetësore është p.sh. + 50 vjet kur je 20 vjeç.

16. Eziston pikëpamja se HIV nuk është provuar plotësisht se është shkaktari i AIDS..., mos vallë u shërbeni interesave të industrisë farmaceutike?

Nuk u shërbejmë interesave të industrisë farmaceutike. Ekzistenca e virusit është provuar tej çdo dyshimi dhe njeriu që e gjeti u dekorua me çmimin Nobel të Mjekësisë. Zhvillimi klinik i sëmundjes është studjuar shumë mirë, prej saj sëmurësh dhe të çon në vdekje vetëm kur nuk përballohet. Efikasiteti i medikamenteve retrovirale është absolutisht i vërtetuar në bazë të studimeve të kryera dhe i miratuar nga Organizmi Qendror Evropian i Medikamenteve. Natyrisht shoqëritë që prodhojnë medikamente për cilëndo sëmundje, si për kancerin dhe diabetin etj. i shesin tek entet e siguracioneve dhe tek privatët.

17. Përse duke përdorur metoda ARN për gjetje gjoja të virusit të AIDS nuk njihni Dr. Kary Mullis i cili e zbuloi? Mos vallë sepse thotë se bëni gabim?

PCR mat sasinë e virusit në gjak tej çdo dyshimi. Natyrisht si çdo teknologji ka mangësitë e saj. Akuzat e Dr. Mullis lidhur me faktin nëse HIV shkakton AIDS u formuluan në vitin 1995 para se mjekimi i trefishtë të tregojë efikasitetin e tij.

18. Krijimi i v i r u s i t të AIDS ishte një fabrikim i përsosur për të zhdukur njerëzit dhe në këtë mënyrë të evitohen luftërat?

Nuk është prodhuar prej njerëzve dhe fatkeqësisht kjo përhapet në rajonet ku ka tronditje shoqërore dhe sidomos luftëra.

19. Medikamentet sot janë akoma shumë të shtrenjta, shoqëritë që supozohet se duan të ndihmojnë njerëzit si e justifikojnë?

Shoqëritë farmaceutike kontribuojnë me kërkimet dhe investimet që bëjnë në fushën e mjekësisë. Është Shteti ai që ka përgjegjësinë e mjekimit të të sëmurëve.



20. Çmimet e medikamenteve janë të paafrushme për shumicën e seropozitivëve. Si justifikojnë shoqëritë prodhuese këtë qëndrim të tyre dhe me ç'kushte do të ishin të predispozhuara të ndryshonin këtë politikë të tyre të çmimeve?

Natyrisht që pyetja duhet t'u drejtohet shoqërive. Gjithësesi lidhur me temën e çmimit dhe mundësinë e sigurimit të medikamenteve mund të theksojmë disa gjëra.

Në shtetet perendimore medikamentet jipen falas nga shteti përmes sistemeve kombëtare të shëndetit. Çmimet përcaktohen me negociata midis shoqërive dhe shtetit (kryesisht në Europë) ose përmes regullave të tregut të lirë (p.sh. në Sh.B.A.). Çmimi i medikamentit duhet të krahasohet me shmangien e kostos që do të çonte në mungesën e mjekimit me medikamente dhe pasojat që do sillte tek shëndeti i të sëmurëve. Nga studimet e kryera dihet se me çmimet e tanishme në Europë për çdo 1 euro mjekim shteti shpëton 3 euro shpenzime kurimi. Veç sa më sipër theksohet përmirësimi i vyer i shëndetit të personave që rrojnë me HIV. Kushtet për vendet në zhvillim janë të ndryshme dhe deri para disa viteve dekurajuese. Pas insistimit të organizatave joqeveritare, si Mjekët pa kufi, shoqëritë më të shumta farmaceutike ranë dakort të mos pretendojnë respektimin e patentës në këto vende dhe lejuan prodhimin e medikamenteve të së njëjtës familje nga shoqëritë vendase (p.sh. Brazili dhe Afrika) ose importin nga India e gjetkë. Kjo është një arritje eveniment që shoqëritë duhet të llogaritin fitime në vendet e zhvilluara dhe të mos pengojnë vendet në zhvillim të kontaktojnë me medikamentet (ku jeton 90% e personave me HIV). Vazhdojnë të ekzistojnë vështërisitë për personat që rrojnë në vende me të ardhura mesatare dhe pabarazi të mëdha shoqërore si p.sh. në Rusi.

21. Është izoluar ndonjëherë HIV? Nëse po kur, kush e realizoi dhe ku është publikuar? Gjithashtu, personat seropozitivë që humbin jetën e tyre, kanë si shkak të vdekjes në shumicën e rasteve cirozën hepatike, gjë që nuk e shkakton AIDS-i por...

Hiv është izoluar në vitin 1983 nga F. Barre-Sinaussi dhe nga R.C. Gallo dhe është botuar në revistën Science.



Shkaku i parë i vdekjes së personave seropozitivë është tuberkulozi i cili gjen terren të favorshëm tek personat ku HIV ka shkaktuar ferimin e imunitetit. Ciroza hepatike ka përqindje të mëdha në përendim, në veçanti në vendet ku personat seropozitivë kanë bashkë-infeksion hepatitin C, përqindje kjo që në Evropë arrin në 1/3 e personave seropozitivë.




3



*informim /
psikologji*



[përgjigje nga KE.ΕΛ.Π.ΝΟ]



1. Çfarë janë medikamentet antiretrovirale?

Janë medikamente kundër virusit. Medikamentet antiretroviralë nuk zhdukin virusin nga trupi por e pengojnë të shumëzohet dhe pakësojnë influencën e tij dëmprurëse tek sistemi imunitar.

2. Çfarë duhet të dijë dikush që bashkëjeton me person seropozitiv?

Të jetë i informuar për mënyrat e ngjitjes së virusit dhe për mënyrat që NUK ngjitet.

3. Është shtuar vitet jetëzgjatja e të sëmurëve me infeksion HIV me aplikimin e «mjekimit antiretroviral të veprimtarisë së lartë» nga viti 1997 e deri më sot?

Po. Mjekimi ul ndjeshëm nivelet e virusit në organizëm, si rezultat personi qëndron i shëndetshëm, por mund të transmetojë virusin.

4. Çfarë analiza duhet të kryejë dikush në qoftë se jeton me një person seropozitiv?

Vetëm kur ekzistojnë kontakte seksuale pa prezervativ ose kur shpohet prezervativi, personi mund t'i drejtohet



Qendrës së Kontrollit që të kryejë analizën e antikorpeve për HIV 6 deri 8 javë pas një infeksioni ventual nga virusi.

5. Është e ekzagjeruar që unë t'i kërkoj shokut/shoqes për të bërë analizat për HIV?

Informim – Prevenim – Ekzaminim

6. Janë në internet qendrat e referimit të AIDS? Sa spesh duhet të bëjmë testin?

Po tek site KE.EA.II.NO dhe në site të ndryshme prestigjioze të Organizatave Joqeveritare. Shpeshtësia është në vartësi direkte me rrezikshmërinë që ka dikush.

7. Përse nuk bëhen mësimet për seksin që në fillore? Përse? Përse kemi frikë t'i themi këto çështje si prindër? Përderisa kemi frikë, pra, le ta bëjmë këtë gjë me imponim Shteti në shkollat!!!

Këto çështje i përcakton Ministria e Arsimit.

8. Kohët e dundit mësova se një miku im shumë i mirë, është bartës. Nuk di si ta pyes, ndihem pak i hutuar. Nuk dua ta vë në pozitë të vështirë dhe vet ai nuk thotë asgjë. Nuk di se çfarë bëhet në këto raste?

Djagnoza pozitive e HIV është tronditëse. Trondit marrëdhëniet e personit me vetveten dhe me mjedisin e tij. Duhet kohë që personi të pranojë realitetin e ri të jetës së tij. Ajo që mund të ofrojë miku është mbështetja morale dhe emocionale.

9. Kur ke AIDS vdes prej tij?

HIV tashmë është një sëmundje kronike.

10. Pyetja ime është se si lufton shteti racizmin që përjeton një bartës p.sh. në punë. Falimenderit.

Nga shoqëria po veprohet për zhdukjen e çdo lloji racizmi ndaj njerëzve që kanë HIV/AIDS.

11. Kur dikush është bartës është mirë t'u rrëfëhet personave reth tij apo duhet ta mbajë sekret për veten e tij?



Frika dhe injoranca krijojnë racizëm. Për këtë arsye duhet të mendohemi për pasojat eventuale të një apokalipsi (sh.përkth.: rrëfim) të tillë.

12. Çfarë duhet të kenë kujdes prindërit e mosbartësve? A ekziston në Greqi kujdes për këta fëmijë?

Trajnimi intereson të gjithë fëmijët. Informimi i prindërve është i domosdoshëm për mënyrat e sakta që ngjitet v i r u s i dhe për mënyrat që nuk ngjitet. Fëmijët ndiqen nga Njësitë e Infeksioneve të Veçanta.

13. Kur dikush shkon drejt stadi që të sëmuret, d.m.th AIDS, mund të rikthehet e të jetë si më parë? D.m.th. seropozitiv?

Kur një person diagnostikohet se ka AIDS, në këtë rast konsiderohet se ky person ka AIDS akoma edhe kur CD4 rriten përsëri apo shërohet nga sëmundja që përcaktoi se ka AIDS.

14. Çfarë duhet të bëj nëse kam djagnozë pozive në test?

Ndjekje nga mjeku në një nga Njësitë e Infeksioneve të Veçanta për të kontrolluar zhvillimin e HIV në organizmin tënd. Shërbimet e mbështetjes psikosociale të KE.EA.PI.NO (Stacioni Konsultativ i Spitalit «Andreas Sygros») ose në linjën telefonike HIV/AIDS për informim dhe mbështetje.

15. Ekziston në Greqi Institucion për mbështetjen e bartësve të AIDS?

Shërbime Mbështetjeje Psikosociale të (KE.EA.PI.NO) - Stacioni Konsultativ i Spitalit «Andreas Sygros») ose në linjën telefonike HIV/AIDS.

16. Një person seropozitiv mund të stërvitet siç stërvitet një mosbartës? Ushtrimi fizik ndihmon apo nuk lejohet tek bartësit?

Ushtrimi fizik ndihmon në gjendjen e mirë fizike të trupit dhe kufizon ndryshimet metabolike eventuale nga përdorimi i medikamenteve antiretroviralë.




17. Bartësit me AIDS duhet të ndhekin një mënyrë konkrete të ushqyeri?

Të ushqyerit e mirë është një mjet shumë i fortë për një përballim të suksesshëm të sëmundjes HIV. Konsultohuni me mjekun tuaj për ushqimet e përshtatshme për secilin prej jush.

18. Gjithashtu kam dëgjuar për disa raste, sigurisht të pakta, njerëzish të cilët kur mësojnë se janë seropozitivë tek virusi, përpiqen t'ua ngjitin edhe njerëzve të tjerë... Përse vallë e bëjnë këtë dhe reagojnë ashtu?

Rastet që janë regjistruar janë minimale dhe nuk kanë të bëjnë me vet virusin si infeksion por me psikopatologjinë e personit.





[përgjigje KE.EL.P.NO]



4



*analiza /
mjekim /
..... statistikë /*



1. Në cilat moshë virusi i AIDS paraqet ekzaltim në vendin tonë dhe në cilin seks?

a) Shumica e personave të deklaruar rishtaz seropozitivë HIV në Greqi -përfshi rastet me AIDS- u përkasin moshave midis 25-44 vjeç (gra: 25-29 vjeç, burra 30-34 vjeç), b) tek burrat (në Greqi 80,9 % e masës së HIV seropozitivë)

2. Në fund të fundit ka mjekim apo nuk ka?

Çrrënjësja e v i r u s i t me medikamentet ekzistuese nuk është e mundur. Por ekziston mjekimi i posaçëm antiretroviral, që është në gjendje të mposhtë v i r u s i n në shkallë të tillë që të rivendoset dhe të ruhet gjendja imunitare (mbrojtja), të pakësohet morboziteti dhe mortaliteti dhe të ruhet cilësia e jetesës së të sëmurëve.

3. Sa janë bartësit e virusit në Greqi?

Numri i përgjithshëm i seropozitivëve me HIV (përfshi edhe rastet e AIDS) që janë deklaruar deri më 31.10.2010 është 10.452 persona.



4. Kam dëgjuar se përdoruesit e drogës dhe personat me ngjyrë janë shumica e personave të infektuar nga virusi? Është e vërtetë?

Lidhur me përdoruesit e injeksioneve intravenoze të substancave narkotike së pari duhet të theksojmë se paraqesin përqindje të larta infeksioni me hepatit B dhe C, sëmundje që lidhen drejtpërsedrejt me zhvillimin e cirozës së mëlçisë dhe kancerit citohepatik. Kjo konsiston tek sjellja e rrezikshme e tyre (duke përdokruar të njejtën shiringë), fakt që i rendit tek grupi me rrezikshmëri të lartë për infektim nga HIV, me përqindje të larta në disa vende (p.sh. Rusi, Portugali). Në Greqi përdoruesit e lëndëve intravenoze narkotike përbëjnë 3,3% të personave seropozitivë të deklaruar me HIV, përqindje e cila konsiderohet e ulët. Ndërkaq ky fakt nuk duhet të na vërë në gjumë dhe në plogështi lidhur me masat e profilaksisë së ngjithjes së v i r u s i t midis përdoruesve.

Lidhur me personat me ngjyrë, nuk ekziston ndonjë predispozitë gjenetike që ata të preken më lehtë nga v i r u s i HIV. Por fatkeqësisht, disa kushte dhe subveçione që konsiderohen të dhëna në vendin tonë, nuk ekzistojnë në disa vende të pazhvilluara apo vende në zhvillim nga ku kanë prejardhjen këta persona. Vështirësitë për t'u kuruar, mungesa e medikamenteve, kontrolli i mangët, si dhe aneksimi shoqëror i këtyre personave janë eventualisht arsyet që këta persona janë më sensibil ndaj v i r u s i t.

5. Medikamentet spermatocide zhdukin v i r u s i n e HIV-it?

Përdorimi i medikamenteve spermatocide si mjet i vetëm i mbrojtjes nga HIV nuk rekomandohet. Do të duhet të shmanget përdorimi i spermatocideve të cilat përmbajnë nonoxynol (N-9), pasi mund të shmangin një shtatzani të padëshiruar, por nuk mbrojnë nga infeksioni HIV dhe nga sëmundje të tjera të cilat transmetohen nëpërmjet kontaktit seksual. Përkundrazi, sipas studimeve klinike, mund të shtojnë rrezikun e infektimit pasi shkaktojnë irritimin e mukuzës së vaginës dhe të zorrës së drejtë.

6. Testi PAP mund të zbulojë v i r u s i n?

Testi PAP nuk është në gjendje të zbulojë v i r u s i n HIV. Me qëllim që dikush të konstatojë nëse është infektuar duhet të kryejë analizën e veçantë në Qendrën



e Referimit dhe Kontrollit të AIDS ose në stacionet e dhurimit të gjakut të spitaleve publike.

7. Në ç' intervale kohore duhet të bëjmë analiza?

Ekzaminimi për virusin e HIV duhet, sipas rregullit, të bëhet pas çdo kontakti seksual pa prezervativ apo sjellje të rrezikshme nën drejtimin e mjekut, i cili do të vlerësojë rrezikshmërinë e situatës. Ndërkaq, në grupe të caktuara të rrezikut të lartë, e mira është që ky kontroll të bëhet një herë në gjashtë muaj apo një herë në vit, me qëllim që të mos vonohet një djagnozë eventuale. Në përgjithësi rekomandohet kontrolli i gjithë masës seksualisht aktive në intervale të rregullta kohore.

8. Rezultatet e analizave janë sekrete?

Përgjigjet e analizave mbrohen nga sekreti mjekësor dhe i komunikohen personalisht personit që kreu analizën.

9. Ku mund të kryejë dikush analizë për të parë nëse ka AIDS?

Që të kryejë analiza për virusin e HIV dikush mund të drejtohet:

Në të gjitha spitalet publike pasi të ketë komunikuar me mjekët e Njësive të Infeksioneve të Veçanta ose me mjekët e stacioneve të dhurimit të gjakut në spitale që nuk disponojnë Njësi të Infeksioneve të Veçanta, ose

Në Qendrat e Referimit dhe Kontrollit të AIDS.

ATHINË: Spitali i Sëmundjeve Veneriane dhe të Lëkurës «A. SYGROS» (tel. 210- 72479025-6), Spitali «O EVANGELISMOS» (tel. 210- 7201242)

SELANIK: Universiteti Aristoteleio i Selanikut, Laboratori i Mikrobiologjisë i Fakultetit të Mjekësisë (tel. 2310-999161)

PATRA: Spitali i Patrës «AGIOS ANDREAS » (tel. 2610 - 227974)

KRETË: Spitali i Iraklios së Kretës «VENIZELEIO-PANANEIO» (tel. 2810- 368142)

ALEKSANDROUPOLI: IKA (tel 25510-20403 ,26810)



10. Analizat e thjeshta të gjaku që bëjmë për Checkup ekzaminojnë edhe AIDS?

Analiza e thjeshtë e gjakut si dhe analizat biokimike të zakonshme që bëjmë gjatë kontrollit rutinë nuk është në gjendje të eksplorojë AIDS. Me qëllim që dikush të konstatojë nëse është infektuar duhet të kryejë analizën e posaçme në Qendrat e Referimit dhe të Kontrollit për AIDS ose në stacionet e dhurimit të gjakut të spitaleve publike.

11. Nëse dikush vjen në kontakt me gjakun e një bartësi, çfarë duhet të bëjë?

Në rastin e kontaktit dermatik me gjak të personit seropozitiv pa ndonjë zgjidhje të vijmësisë së lëkurës nuk ka rrezik për ngjitje të v i r u s i t. E njëjta gjë ndodh edhe në rastin kur gjaku gjendet në mjedis për një periudhë kohe disi të gjatë, me pasojë v i r u s i të jetë shkatërruar. Në rastin e kontaktit hemoragjik seksual, aksidenteve hemoragjike në të cilat plekset edhe person seropozitiv ose i dyshimtë si seropozitiv për infeksion HIV, ose shpimit / prerjes me sende të përdorura nga seropozitivi, situata duhet të vlerësohet imediatisht në ndonjë prej Njësisë të Infeksioneve të Veçanta e shumta brënda 48-72 orësh. Sigurisht në çdo rast konsiderohet i dhënë ofrimi i ndihmës urgjente tek vendi i ngjarjes (lavazhi i imtë i plagës me sapun dhe ujë ose larje antiseptike e plagës së mukozave të syrit me solucion fiziologjik).

12. Medikamentet që duhen për mjekimin i paguan shteti?

Shpenzimet për mjekimin farmaceutik të të sëmurëve me HIV/AIDS përballohen plotësisht nga entet siguruese.

13. Përse ekzistojnë më shumë raste në Afrikë?

Fakti që në Afrikë vërehen rastet më të shumta e HIV/AIDS, lidhet me kushtet zotëruese në këto vende. Personat që banojnë aty nuk e kanë të lehtë të kryejnë kurim shëndetësor dhe mjekësor - farmaceutik, nuk kryhet kontrolli dhe ndjekja e rregullt e shtatzanisë (si rezultat të kemi përngjitje të larta transmetimi direkt të virusit) dhe për arsye të kushteve, shpesh vuajnë edhe nga sëmundje të tjera të cilat rëndojnë gjendjen e shëndetit të tyre (p.sh. tuberkulozi, malarja, hepatitet). Pra është e natyrshme që të kemi përqindje më të larta të personave



seropozitivë me HIV në vendet e Afrikës.

14. Është e vërtetë se virusi sapo del në temperaturën e mjedisit të jashtëm shkatërrohet?

Në përgjithësi virusi HIV është shumë i ndjeshëm në mjedisin e jashtëm dhe në kundërshtim me disa baktere dhe micide, nuk është i aftë të riprodhohet jashtë mjedisit të tij. Pra, rreziku teorik i ngjijes mjedisore të tij është pothuajse zero.

15. Ekziston test AIDS me pështymë?

Në fakt ekziston test analize e antikorpeve kundër HIV që kryhet me marrjen e mostrave të pështymës (transudacionit të mukozës orale). Testi kryhet anonim dhe falas dhe rezultati i tij jipet në një kohë veçanërisht të shkurtër (20-25 minuta) dhe për këtë quhet rapid test. Ky test është mjaft i saktë, megjithatë në rast rezultati pozitiv nevojitet një metodë e afirmuar për të bërë provën. Me qëllim që dikush të kryejë rapid test mund të drejtohet tek Ambulancat e MKO (sh.përkth.: Organizata Joqeveritare) PRAKSIS (tel. 800 11 11 600).

16. Sa vjet mund të jetojë një fëmijë që vuan nga AIDS?

Infeksioni HIV përbën tashmë një sëmundje kronike që përballohet me mjekimin e posaçëm antiretroviral. Përgjithësisht jetëzgjatja është rritur mjaft në krahasim me vitet e kaluara. Ndërkaq mbijetesa e çdo të sëmuri individualizohet dhe varet nga fakti se sa shpejt bëhet djagnostikimi i sëmundjes, nga shkalla e pranimit nga i sëmurit i mjekimit të tij, nga ekzistenca e sëmundjeve shoqëruese etj.







[Ligji 3304/2005]

.....5.....

zbatim i
..... parimit të
trajtimit të
njëjtë

pavarësisht nga origjina
racore ose nacionale,
besimeve fetare ose bindjeve
të tjera, invaliditetit, moshës
apo orientimit seksual

► Zbatim i parimit të trajtimit të njëjtë,

pavarësisht nga origjina racore
ose nacionale, besimeve fetare ose
bindjeve të tjera, invaliditetit,
moshës apo orientimit seksual

[Teksti i plotë i Ligjit 3304/2005 disponohet në
internet në adresën :[Htp: // www.ypakp .gr/uploads/
files/2538.pdf](http://www.ypakp.gr/uploads/files/2538.pdf)]

Neni 1

Qëllim i këtij ligji është vendosja e kuadrit të përgjithshëm të rregullimit për luftimin e dallimeve për arsye fetare ose bindjeve të tjera, invaliditetit, moshës ose orientimit seksual në sektorin e punësimit [...] në mënyrë që të ruhet parimi i zbatimit të trajtimit të barabartë.

Neni 2

Parimi i trajtimit të barabartë.

1.Ndalohet dallimi direkt apo indirekt për një nga arsyet që referohen tek neni 1.

2. Si dallim konceptohet edhe ngacmimi apo çdo veprim tjetër fyes, i cili demonstrohet me sjellje të padëshiruar që lidhet me një nga arsyet e nenit 1 dhe ka si synim ose rezultat fyerjen e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, poshtërues, përlulës ose agresiv. Gjatë specifikimit të kuptimit të ngacmimit merren parasysh edhe doket



e vyrtytshme komunikuese.

3. Si dallim kuptohet gjithashtu cilido urdhër për zbatimin e trajtimit diskriminues në dëm të një personi për cilëndo arsye që përmendet te neni 1.

Neni 3

Kuptimi i dallimeve.

Bëhet fjalë për diskriminime për hir të racës ose origjinës etnike.:

a) Konsiderohet dallim direkt, kur për arsye të origjinës racore ose etnike, një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa është trajtuar, trajtohet apo do të trajtohet një person tjetër në situatë analoge.

b) Quhet dallim direkt, kur në pamje të parë një dispozitë neutrale, kriter apo praktikë mund të çojë persona me origjinë racore apo etnike të caktuar në pozita minorente në krahasim me persona të tjerë, përveç nëse dispozita, kriteri apo kjo praktikë justifikohen objektivisht nga një qëllim i mirë dhe mjetet e arritjes së tij janë të përshtatshme dhe të domosdoshme.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1.Me rezervën e paragrafit 2 të këtij neni dhe nenit 5, dispozitat e këtij kapitulli zbatohen tek të gjithë personat në sektorin publik dhe privat lidhur me:

a) kushtet e punësimit dhe të angazhimit në përgjithësi, përfshi kriteret e përzgjedhjes dhe kushteve të marrjes në punë, pavarësisht nga sektori i veprimtarisë dhe nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe kushtet e shërbimit dhe të zhvillimit profesional,

b) kontaktim në të gjitha llojet dhe nivelet e orientimit profesional, formimit profesional, trajnimit dhe orientimit profesional, përfshi edhe përfitimin e përvojës praktike profesionale,

c) kushtet dhe konditat e punës dhe angazhimit përfshi edhe ato që u përkasin pushimit nga puna dhe shpërblimeve.

d) cilësinë e anëtarësisë dhe pjesëmarrjes në organizatat e punonjësve ose të punëdhënësve ose në cilëndo organizatë profesionale përfshi edhe avantazhet që rrjedhin nga pjesëmarrja në to,

e) mbrojtjen sociale përfshi sigurimet shoqërore dhe



kurimit shëndetësor,

ë) imbursimet sociale,

f) arsimin,

g) kontaktin me disponimin dhe ofrimin e të mirave materiale dhe shërbimeve për publikun, duke përfshirë edhe strehimin.

2. Dispozitat e këtij kapitulli nuk zbatohen në rastet që parashikohet trajtim tjetër për arsye të shtetësisë dhe nuk prekin dispozitat që rregullojnë hyrjen dhe qëndrimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi në territorin grek as trajtimin që lidhet me gjendjen e tyre ligjore si shtetas të vendeve të treta ose personave pa shtetësi.

Neni 6.

Veprimtari pozitive

Nuk përbën dallim marrja ose ruajtja e masave të veçanta me qëllim parandalimin ose kundërbalancimin e disavantazheve, për arsye të origjinës racore apo etnike.

Neni 13

Ofrim mbrojtjeje

1. Në rastin e mosrespektimit të parimit të trajtimit të barabartë në kuadrin e veprimtarisë administrative, tek i dëmtuari ofrohet, tej mbrojtjes gjyqësore, mbrojtje edhe në bazë të neneve 24 deri 27 të Kodit të Procedurës Administrative (Ligji 2690/1999 Fletorja Zyrtare (ΦΕΚ) 45 Α).

2. Përfundimi i marrëdhënies në kuadrin e sëcilës u krye fyerja, nuk përjashton mbrojtjen nga shkëlja e parimit të trajtimit të barabartë.

3. Personat juridikë të cilët kanë si qëllim garantimin e ruajtjes së parimit të trajtimit të barabartë pavarësisht nga origjina racore apo etnike, besimeve fetare ose bindjeve të tjera, invaliditetit, moshës apo orientimit seksual, mund të përfaqësojnë të dëmtuarin në gjykata dhe ta përfaqësojnë përpara cilitdo autoriteti administrativ apo organi administrativ, pasi të merret më parë miratimi i tij me dokument noterjal apo dokument privat i legalizuar për autenticitetin e firmës.



Neni 14.

Pesha e provës

1. Kur i dëmtuari paraqet fakte se nuk u respektua parimi i trajtimit të barabartë dhe provon para gjykatës apo autoritetit kompetent administrativ fakte reale prej të cilave mund të konkludohet dallim direkt ose indirekt, pala ndërgjyqëse mbart peshën që të vërtetojë në gjykatë ose autoriteti administrativ të argumentojë se nuk ekzistuan rrethanat që përbëjnë shkëlqe të këtij parimi.
2. Paragrafi i mësipërm nuk vlen në gjyqin penal.
3. Paragrafit 1 vlen edhe në rastin e paragrafit 1 të nenit të mëparshëm.

Neni 15

Mbrojtja ndaj kundërmasave

Mbrojtja sipas nenit 13 nënkupton edhe pushimin (nga puna) ose në përgjithësi trajtim jo të përshtatshëm të një personi, trajtim i cili demonstron si kundërmasë për denoncim apo kërkesë ofrimi mbrojtjeje ligjore për garantimin e respektimit të parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 16

Sanksione penale

1. Ai që, sipas këtij ligji, shkel ndalimin e trajtimit diskriminues për arsye të origjinës racore ose etnike, besimeve fetare ose bindjeve të tjera, invaliditetit, moshës apo orientimit seksual gjatë marrëdhënieve shkëmbyese për t'i ofruar publikut të mira materiale apo shërbime, dënohet nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet burg dhe me dënim monetar nga njëmijë (1.000) deri në pesë mijë (5.000) Euro.



Tashmë është mjaft e keqe që ekzistojnë disa njerëz që vdesin nga AIDS, por nuk mund të lejojmë që të ekzistojnë disa njerëz që vdesin nga padituria.

Elisabeth Taylor (1932 – 2011)